




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Telekomi i Kosovës
Agron MUSTAFA
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/19 KPM vs Telekomi i Kosovës
Ref:1708/756KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/19 – Komisioni i Pavarur i Media (KPM) kundër Telekomi i Kosovës (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse, është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 26 dhjetor 2016. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës, obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së, dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM, ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
3. KPM, me datën 7 mars 2017 ka realizuar një monitorim në selinë e Palës Përgjegjëse për pajtueshmërinë e me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01. Pas vlerësimit ligjor të marrëveshjeve për të drejta të ritransmetimit, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk posedon marrëveshje për 43 kanale ndërkombëtare dhe vendore, si: Alsat M, T-1 (Top Channel), T-2 (Klan TV), RTV 21 Mix, RTV21 Junior, Kika, Nickelodeon, Peace TV, RTV21 Plus, Eurosport DE, RTV 21 Popullore, Ziko TV HD, Turbo Channel, Music Box TV, Art HD, NTV, Dasma TV, CNN, BBC World, Euro News, DW, CNBC, Bloomberg, Al Jazeera Balkans, Hayat BIH, SAT 1, RTL, RTL2, Pro Sieben, VOX, 3 SAT, Comedy Central, ZDF, ZDF Kultur, TV8, SHOW TV, Euro Star, Euro D, TRT 1, TRT 3 Plus, RAI 1, TVE, Canale 24.
4. KPM, gjatë monitorimit ka gjetur po ashtu se Pala Përgjegjëse nuk i ka përfshirë në listën e kanaleve të veta kanalet e përcaktuara nga KPM me statusin e bartjes së obligueshme, si: TV Kim, TV Kiss, TV Ballkan, TV Opinion, TV Prizreni, TV Herc, TV Iliria, TV Liria, TV Mir, TV Most, TV Puls, TV Vali dhe TV Zoom.

5. KPM, nëpërmes një shkrese me datën 22 mars 2017, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për gjetjen në shkelje për ritransmetimin e 43 kanaleve pa të drejta transmetimi dhe e ka udhëzuar që brenda pesë (5) ditësh të ofrojë dëshmi për të drejtën e ritransmetimit të kanaleve në fjalë.
6. KPM, me datën 27 mars 2017, ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës pretendohet se ata kanë filluar kontaktet me operatorë televiziv, si vendorë dhe ndërkombëtarë dhe shumë shpejtë do të na njoftojnë për marrëveshjet e arritura.
7. KPM, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 29 mars 2017 ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pse sipas përgjigjes së tyre është duke u munduar t'i arrijë marrëveshjet për ritransmetimin e kanaleve, ka filluar t'i ritransmetojë ato pa marrëveshje paraprake dhe vazhdon t'i ritransmetojë, duke vepruar në shkelje të vazhdueshme të Rregullores KPM-2016/01.
8. KPM, me datën 5 prill 2017, ka pranuar edhe një ankesë nga IPKO, ndaj Palës Përgjegjëse për ritransmetim ilegal të kanaleve Top Channel dhe Klan TV.
9. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 7 prill 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01.
10. KPM, për të verifikuar pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2016/01 pas Njoftimit për Shkelje, ka iniciuar edhe një monitorim shtesë me datë 8 maj 2017 në selinë e Palës Përgjegjëse. Në bazë të Raportit të monitorimit, të po asaj date, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon t'i ritransmetojë 43 kanale pa marrëveshje valide për të drejtat e autorit si dhe ende nuk i ka përfshirë në platformën e saj programe kanalet me statusin e bartjes së obligueshme.

Analiza Ligjore

11. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse, ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“I licencuari obligohet të bëjë shpërndarjen e ofruesve të shërbimit medial bazuar vetëm në marrëveshje valide për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale”.

Pala Përgjegjëse ka shkelur këtë nen duke i ritransmetuar 43 kanale pa marrëveshje valide të transmetimit.

Neni 9, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

“Me qëllim të sigurimit të qasjes së publikut në ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuale, që ofrojnë përmbajtje programore në interes të përgjithshëm të tyre, dhe në mënyrë që të promovohet dhe sigurohet pluralitet medial, i licencuari i nënshtrohet obligimit për bartje të obligueshme”.

Pala Përgjegjëse në bazë të këtij neni e ka obligim t'i bartë të gjitha kanalet të cilat KPM i ka përcaktuar për bartje të obligueshme, ato janë: TV Kim, TV Kiss, TV Ballkan, TV Opinion, TV Prizreni, TV Herc, TV Iliria, TV Liria, TV Mir, TV Most, TV Puls, TV Vali dhe TV Zoom.

12. KPM, duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1 dhe nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
13. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse përkundër komunikimit me KPM-në që nga data 7 mars 2017 dhe përkundër përgjigjeve të tyre se do të vijnë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2016/01, nuk kanë arritur t'i sigurojnë marrëveshjet valide të të drejtave të autorit për ritransmetimin e 43 kanaleve. Po ashtu, nuk kanë arritur as t'i përfshijnë në listë kanalet për të cilat janë të obliguar t'i bartin.
14. KPM-së, ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1 dhe nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.
15. KPM, gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse, bie ndesh me nenin 4, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2016/01 i cili përcakton se:

“Kur i licencuari gjen se një shërbim i programit ka përmbajtje ilegale, i licencuari duhet menjëherë ta ndërpresë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet”

Pala Përgjegjëse edhe pse është njoftuar se është gjetur në shkelje dhe nuk ka arritur të sigurojë marrëveshje valide të të drejtave të autorit për ritransmetimin e 43 kanaleve, nuk e ka ndërprerë ritransmetimin e tyre.

16. KPM, duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 4, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, duke i ritransmetuar 43 kanale pa marrëveshje valide për ritransmetimin e tyre si dhe ende nuk i ka përfshirë në platformën e saj programore kanalet me statusin e bartjes së obligueshme.

Vendimi

17. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 4, paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.


18. KPM, kërkon nga Pala Përgjegjëse të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e 43 kanaleve të cilët vazhdon t'i bartë pa të drejta për transmetim.
19. KPM, gjithashtu, bazuar në nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01, kërkon nga Pala Përgjegjëse t'i përfshijë kanalet e caktuara nga KPM në listën e bartjes së obligueshme.
20. Komisioni, bazuar në 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me Vërejtje Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 4, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenit 9, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

E drejta për Ankesë

21. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
22. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



01.08.2017

datë